



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primitje Me/Dana <u>19.12.2012</u> vit/god			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-	013	/1460	

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) lidhur me nenin 82.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/1008, Rekomandimit të MAPL-së dhe nenit 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012 aprovon këtë:

## VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË AUTOPARKINGJEVE  
NË QYTETIN E VITISË OVL TË UÇK-SË DEGA NË VITI

### Neni 1

Me këtë vendimi, Kuvendi i Komunës së Vitisë **SHFUQIZON** Vendimin për dhënie në shfrytëzim të autoparkingjeve në qytetin e Vitisë Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dega në Viti me nr 01-013/1196 të datës 05.10.2012.

### Neni 2

Shfuqizimi i vendimit nga neni 1 i këtij vendimi bëhet në bazë të rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, dhe rrjedh si pasojë e pengesave ligjore, sepse me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale duhet të zbatohen kriteret e përcaktuara me Ligjin për Prokurim, neni 5 dhe 7 të Ligjit nr 03/L-226, si dhe Udhëzimi Administrativ nr 2012/02 për zbatimin e Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

### Neni 3

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendim për dhënie në shfrytëzim të autoparkingjeve të qytetit të Vitisë, OVL së UÇK -së dega në Viti, 01 nr 013/1196 të datës 05.10.2012 dhe pushon të prodhon efekte juridike.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës së Vitisë.

### Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

01 Nr \_\_\_\_\_  
Viti, 18 dhjetor 2012



KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
KRYESUESI  
Skenderbe Hebibi

*Skenderbe Hebibi*